



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Zoran Todiq, Kryetar i Komunës së Leposaviqit Marko Rakic, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Leposaviqit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 20.05.2026 -VI-020-314
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin nr. 447, për emërimin e anëtarit të komitetit për politikë dhe financa të Kuvendit të Komunës së Leposaviqit
I miratuar më datë: 28.04.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.04.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Arsyetim

Vendimin nr. 447, për emërimin e anëtarit të komitetit për politikë dhe financa të Kuvendit të Komunës së Leposaviqit.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Leposaviqit, është bazuar në nenin 12, 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Leposaviqit e mbajtur me datë 28.04.2026, i miratuar me 11 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Zoran Todiq , gradonačelnik opštine Leposavić Marko Rakic , predsedavajući Skupštine opštine Leposavić
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi , ministar MALS-a, Jeton Qela , generalni sekretar u MALS-u,
Od:	Erbilin Hetemi , direktor Pravnog odeljenja , MALS Dana: 20.05.2026 -VI-020-314
Službenik-ca: za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa , rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata i akata gradonačelnika opštine rukovodilac odseka za monitorisanje opština.
Službenik-ca: za izradu pravne procene:	Maltin Shala , Viši službenik za razmatranje zakonitosti akata opštine i akata predsednika opštine
Predmet:	Potvrda zakonitosti
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članovima 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o Administrativnom preispitivanju akata opština i Uredbom (VRK) br. 03/2026 o Postupku administrativnog preispitivanja akata opština, a na osnovu zakonskih nadležnosti Ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o Oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je primilo na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći akt opštine:

Odluku br. 447, o imenovanju člana Komiteta za politiku i finansije Skupštine opštine Leposavić.
Usvojena dana, 28.04.2026.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 29.04.2026.

